



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit-Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN) më datën 20.02.2014 realizoi **vizitë pasuese, nate** në SP-Karposh. Kjo vizitë u përqëndrua në disa konstatime negative në Raportin e veçantë të vitit 2012 dhe vlerësimin e implementimit të rekomandimeve të dhëna.

Gjatë vizitës pasuese të cilën e realizoi Mekanizmi Parandalues Nacional u konstatua se numri më i madh i rekomandimeve të MPN-së të dërguara pranë Stacionit policor-Karposh u zbatuan pjesërisht, ndërsa një numër i vogël u zbatua tërësisht. Megjithatë, për shkak se vizita ishte në orët e natës një pjesë e rekomandimeve nuk u vlerësua.

U konstatua se në regjistrin e personave të cilëve në çfarë do baze u është kufizuar liria për lëvizje nuk shfrytëzohet korrektori, por të dhënat e evidentuara në mënyrë të gabueshme shlyhen me një linjë, me çka nga njëra anë vihet në pah pavlefshmëria e asaj të dhëne, ndërsa në anën tjetër ajo e dhënë është qartë e lexueshme. Udhëheqësi i ndërresës theksoi se në SP shfrytëzohen procesverbalë të ri për ndalim, ndërkaq njëkohësisht hartohet edhe Aktvendimi për ndalim (konform dispozitës së nenit 160 paragrafit 1 të Ligjit për procedurë penale, Gazeta zyrtare 150/2010). Gjithashtu nga inspektimi në regjistrin për ndalim MPN konstatoi se, ka rrjedhë të logjikshme kohore të ngjarjeve, më saktë është evidentuar privimi ose arrestimi fillestar para se të vjen deri te ndalimi në stacionin policor.

Ekipi i MPN-së realizoi inspektim edhe në toaletët, me ç'rast konstatoi se nga të njëjtit janë eliminuar materialet dhe sendet e rrezikshme, përkatësisht nga toaleti është larguar pasqyra e cila ishte nga materiali i brishtë, si dhe mbajtësi metalik për letër toaleti, mirëpo, nga toaleti akoma nuk është larguar gypi për dush. MPN-ja konsideron se edhe gypi për dush duhet larguar me qëllim që personi i ndalur të mos vetlëndohet ose t'i shkaktojë lëndime zyrtarëve policorë.

Njëherazi u konstatua se ambienti për marrjen në pyetje dhe bisedë me personat e privuar nga liria nuk është pajisur në mënyrë përkatëse me kompjuter dhe paisje tjera teknike. Gjithashtu, kabllot për hapjen e dyerrve akoma nuk ishin izoluar në mënyrë përkatëse. Ekipi i MPN-së gjatë vizitës pasuese konstatoi se njëra nga ambientet e vjetra për ndalim është dukshëm e shëndruar në magazinë për ruajtjen e dokumenteve të arkivuara, ndërsa në ambientin tjetër akoma ka krevat dhe batanije të vjetra, dhe gjithashtu nuk është i mbyllur. Ekipi i MPN-së edhe një here rekomandon që dy ambientet të shfrytëzohen dhe bëhen funksionale, që të mos vjen deri te keqpërdorimi i tyre.

Si rezultat i vizitës së realizuar, Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional hartoi raport të veçantë në të cilin vuri në dukje gjendjet pozitive dhe negative dhe dha rekomandime përkatëse pranë Ministrisë për Punë të Brendshme dhe pranë kryeshefit të Stacionit Policor-Karposh me qëllim të eliminimit të mangësive të identifikuara.